



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Teori dhe praktikë përkthimi në Gjuhën B

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore; 4 kredite; 10 leksione / 30 seminare

Viti / Semestri: Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore: Ky kurs pfron çështje që lidhen me integrimin e përkthimit në fushën e shkencave tekstuale dhe lidhjen e tij me gjuhësinë (kryesisht me gjuhësinë e tekstit dhe sociolinguistikën) dhe gjuhësinë. Janë analizuar çështjet që lidhen me terminologjinë e përdorur ndërkombëtarisht dhe trajtohen kategoritë e ekuivalencës dhe sinonimisë. Rrënjët e përkthimit si proces njohës i kërkojmë te “Kratylos” i Platonit, te “Mbi interpretimin e Aristotelit”, te “Mbi sintezën e emrave” të Dionisios Alikarnasos dhe te “De oratore” të Ciceronit.

Objektivat specifikë lëndore:

1. Studenti të familjarizohen me përkthimin si një degë e veçantë e Gjuhësisë dhe Filozofisë së Gjuhës nëpërmjet teksteve transgjuhësore.
2. Të njihen me konceptet bazë të përkthimit (si funksionon ekuivalenca dhe sinonimia, të cilat janë shtyllat e të menduarit përkthimor, përkthimet parësore-sekondare, faza semantike dhe nominale e përkthimit etj.)

Rezultate të pritshme:

1. Të jetë i aftë të fitoj formimin e nevojshëm teorik, i cili do të shërbejë si bërthamë teorike për detyrat që do të ftohen të dorëzojnë në lëndët e semestrave më të gjatë dhe që do t'i shoqërojë gjatë gjithë kursit të tyre të përkthimit.
2. Të jenë të aftë të kuptojnë më mirë aspektet më të thella të përkthimit në vetvete